



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

NJËSIA PËRGJEGJËSE

Lënda : Mbi miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil për periudhën Gusht – Dhjetor 2018

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 18, “Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil”, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” si dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr.86/2018, datë 19/07/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”,

VENDOSA:

1. Miratimin e planit të pranimit/rekrutimit në shërbimin civil, për periudhën Gusht-Dhjetor 2018.
2. Deklarimin e pozicioneve të lira për të cilat do të organizohen procedurat përkatëse të konkurrimit si më poshtë:

**PLANI VJETOR I PRANIMEVE/REKRUTIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR PERIUDHËN GUSHT- DHJETOR 2018
(sipas pozicioneve, kategorisë / klasës)**

Pozicioni	Vende vakante	Kategoria-	Klasa
Inspektor në Drejtorinë e Hetimit Administrativ	2	Niveli i ulët drejtues (për një pozicion do të zbatohet neni 26 i Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil	III-A
Inspektor në Drejtorinë për të Drejtën e informimit	1	Niveli i ulët drejtues Lëvizje paralele e ngritje në detyrë	III-A
Inspektor në Sektorin e Procedurave administrative	2	Niveli i ulët drejtues Lëvizje paralele e ngritje në detyrë	III-A
TOTALI	5		